



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Departamenti i Rinisë / Departman Omladine / Department of Youth

FTESË PËR GRANTE PËR START-UP

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Departamenti i Rinisë (DIR), duke u bazuar në Strategjinë Kosovare për Rini 2013-2017 dhe Planin e Veprimit për Rini 2015-2017 si dhe në Rregulloren Nr.09/2015 për subvencionimin në fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit do të ofrojë grante për të rinjtë e papunësuar të cilët kanë përfunduar trajnimin nga programi i trajnimeve për vitin 2016 të MKRS-së, implementuar nga MDA.

Qëllimi i granteve:

Programi ka për qëllim krijimin e mundësive për punësimin e të rinjve përmes mbështetjes për ndërmarrësit e rinj nëpërmes financimit për hapjen e bizneseve të reja.

Grantet janë dizajnuar të ofrojnë stimulime për ndërmarrësit e rinj dhe ambicioz në vlerë max 3,000.00 euro.

Synohet që rreth 20 të rinj (përfutues të trajnimit të lartcekur) nga të gjitha rajonet e Kosovës të përfitojnë nga ky projekt.

Përparësi do t'ju ipen ideve inovative në:

- Sektorin e industrisë së lehtë;
- Sektorin e turizmit;
- Sektorin e IT
- Sektorin e dizenjimit, ondulimit, floktarisë, artizanatit.

Të drejtë aplikim kanë:

- Të jetë i/e certifikuar për **PËRFUNDIM TË SUKSESËSHËM TË TRAJNIMIT** nga programi i trajnimeve për vitin 2016 të MKRS-së, implementuar nga MDA
- Të jenë të moshës 18 deri 24 vjeçar
- Të kenë ide kreative për themelimin e biznesit
- Të mos jetë pronar ose bashkëpronar i ndonjë biznesi të regjistruar
- Të mos jetë i punësuar në sektorin publik ose privat
- Të mos ketë përfituar më herët grante nga MKRS ose KYDP.

Financimi i Planeve të Biznesit bëhet duke u bazuar në parimet si në vijim:

- Konkurrueshmëria;
- Trajtimi i barabartë dhe mos-diskriminimi i aplikuesve;
- Transparenca në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve;
- Parimi i efektivitetit dhe i ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara;

- Respektimi i plotë të parimeve të llogaridhënies, dhe raportimit në shfrytëzimin e fondeve publike;
- Ruajtjen e pavarësisë së përfituesve;
- Parandalimin të çfarëdo konflikti të interesit;

Kushtet dhe Kriteret e përzgjedhjes :

Vlerësimi i Planeve të Biznesit do të bëhet nga një komision profesional duke ju dhënë përparësi kriterëve të më poshtme:

- Idea e biznesit dhe plani praktikisht i realizueshëm i biznesit;
- Qasja e propozuar për zbatimin e Planit të Biznesit dhe mënyra e adresimit të Idesë së Biznesit;
- Kapacitetet e aplikuesit për realizimin e Planit të Biznesit konform objektivave të përcaktuara dhe synimeve të thirrjes për grante për start-up;
- Qëndrueshmëria e Biznesit;
- Kostoja e fillimit të një biznesi që financohet nga MKRS është max 3,000.00 euro;
- Vetëm asetet fikse do të financohen nga MKRS;
- Burimet e vetë financimit duhet të jenë të paktën 30% e investimeve të përgjithshme; dhe
- Një deklaratë e gatishmërisë së aplikuesit për të filluar një biznes brenda 30 ditë pas njoftimit të përzgjedhjes përfundimtare të komisionit vlerësues.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV e aplikuesit;
- Kopja e dokumentit identifikues përmes se cilës dëshmohet se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Kopja e certifikatës së trajnimit nga programi i trajnimeve për vitin 2016 të MKRS-së, implementuar nga MDA;
- Plani i Biznesit i punuar në të gjitha elementet e strukturës së Plan biznesit;
- Plani investiv i detajuar për fillimi të biznes;
- Pasqyra e të ardhurave (Fitim/Humbja) (e dëshiruar);
- Projektimi i Rrjedhës së Parasë (e dëshiruar);

Skema e granteve

- Deri në njëzetë Plane të Biznesit më të vlerësuara nga komisioni profesional do të financohen max 3,000.00 Euro, të cilat mund të merren pas regjistrimit të biznesit dhe pas fillimit të implementimit nga investimet vetanake;
- Përfituesit e granteve për fillim të biznesit do të nënshkruajnë KONTRATË me MKRS jo më larg se 10 ditë nga data e përfundimit të investimeve vetanake;
- Kohëzgjatja e kontratës për Implementim e Planit të Biznesit do të jetë 1 vjeçare;
- Përfituesit e granteve për Biznes-Plane do të monitorohen dhe vlerësohen nga MKRS deri në përfundimin e suksesshëm të projektit;
- Pas përfundimit të të gjitha investimeve, përfituesit obligohen të sjellin në MKRS raporte financiare dhe narrative.

Aplikacionet e përfituesit që kanë përfunduar trajnime të mëparshme si dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Ftesën e Aplikimit për Grante për start-up biznese mund ta gjeni në www.mkrs-ks.org tek rubrika [SHPALLJE - konkurse për projekte](#)

Planet e Biznesit duhet të dërgohen në formë të shkruar në tri kopje të mbyllura në zarfe me mbishkrimin (Aplikacion për Grante) në adresën e mëposhtme:

Sheshi Nëna Terezë; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra # 22;

10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Afati i fundit për aplikim është data 06 Mars 2017, ora: 15:00

Aplikacionet nuk pranohen përmes Postës apo përmes e-mail. Për informata të tjera mund të kontaktoni në e-mail: burim.mexhuani@rks-gov.net ose në tel: 038/211-438